



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr ____prot

Datë _____.____.2024

**VENDIM
Nr. 385, datë 29.07.2024**

**PËR
KUALIFIKIMIN PËR EMËRIM TË KANDIDATES TË DIPLOMUAR NË SHKOLLËN
E MAGJISTRATURËS, ZNJ. {...}**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 29.07.2024, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe Relacionin “Për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për emërim si magjistrat, profili gjyqtar, të kandidatës znj. {...}”, relatuar nga z. Ilir Rusi, si dhe pasi shqyrtoi propozimin për kualifikimin e kandidatës znj. {...} dhe vijimin e procedurës së emërimit të saj si gjyqtare,

VËREN:

I. PROCEDURA E VERIFIKIMIT

1. Znj. {...} është kandidate për t’u emëruar magjistrat, profili gjyqtar, në kushtet kur ajo përfshihet në listën e të diplomuarve për kandidatët gjyqtarë në përfundim të vitit akademik 2023-2024, përcjellë nga Shkolla e Magjistraturës, në përputhje me nenin 34, pika 1/1, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar (më poshtë referuar si Ligji i Statusit), me anë të postës elektronike në datë 02.07.2024 dhe protokolluar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor me aktin nr.3499 prot., datë 03.07.2024.

2. Po ashtu, znj. {...} nuk ka kërkuar të emërohet magjistrat në vitin pasardhës, sikurse lejohet nga neni 32, pika 2, i Ligjit për Statusin, sipas të cilit: *“2. I diplomuari që përmbush kriteret e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, për shkaqe të justifikuara, jo më vonë se dy javë nga data e publikimit të listës së të diplomuarve, mund të kërkojë që të emërohet si magjistrat në vitin pasardhës”.*

3. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për emërim si magjistrat, profili gjyqtar, në përputhje me nenin 34, pika 1, të Ligjit për Statusin, si dhe Vendimin e tij nr. 75, datë

23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë” (më poshtë referuar si Vendimi 75/2019), Këshilli i Lartë Gjyqësor, me Vendimin nr. 14, datë 18.01.2024, vendosi *fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të rekrutimit si gjyqtar të kandidatëve për magistratë, profili gjyqtar, që pritet të diplomohen në vitin akademik 2023-2024*, duke caktuar relatorin për çdo kandidat, ku në bazë të shortit, për kandidaten znj. {...}, si relator u caktua z. Alban Toro.

4. Më datë 19.01.2024, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Seksionin A, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, kandidatja znj. {...}, në rrugë elektronike, u njoftua: - për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit; - për caktimin e relatorit të kësaj procedure verifikimi; - për të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatorit të caktuar dhe/ose të çdo anëtar tjetër të Këshillit, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi. Po ashtu, kandidatja u njoftua edhe për detyrimin për plotësimin e formularit deklarues për adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktit telefonik, për qëllimet e procedurës së verifikimit ndaj saj, formular ky që i është bashkëngjitur njoftimit.

5. Brenda afatit treditör, kandidatja znj. {...}, depozitoi rregullisht të plotësuar formularin deklarues për adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktit telefonik, për qëllimet e procedurës së verifikimit ndaj saj. Nga ana tjetër, në këtë afat, kandidatja nuk parashtrroi ndonjë pretendim në lidhje me relatorin e caktuar për procedurën e verifikimit ndaj saj apo për ndonjë anëtar tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

6. Më datë 29.01.2024, bazuar në pikën 8, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, kandidates znj. {...}, në rrugë elektronike, iu dërguan formularët dhe autorizimet përkatëse (të përcaktuara në pikën 6, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019) që duhet të plotësoheshin dhe dorëzoheshin prej saj në kuadër të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit.

7. Brenda afatit pesëditor, kandidatja znj. {...}, depozitoi në zyrën përkatëse të Këshillit formularët dhe autorizimet përkatëse, ndërsa brenda afatit (sipas pikës 4, Seksioni A, Kreu IX, të Vendimit 75/2019), ajo dorëzoi rregullisht edhe formularin “Deklaratë e pasurisë dhe interesave privatë të kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë” pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (më poshtë referuar si ILDKPKI).

8. Gjatë procedurës së verifikimit, më datë 29.01.2024, bazuar në pikën 10, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, përmes shkresave të veçanta, u kërkua informacion dhe raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës, përcaktuar në nenin 32 të Ligjit të Statusit, për kandidatët për gjyqtarë të diplomuar në Shkollën e Magjistraturës, ndër ta edhe për znj. {...}.

9. Institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës, kanë përcjellë për Këshillin e Lartë Gjyqësor informacionet dhe raportimet e tyre në kohë të ndryshme (siç do të përshkruhet më poshtë).

10. Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 147/b dhe 149, pika 5 e Kushtetutës së Republikës, në nenin 276, pika 7 e Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, vendimit të Këshillit nr. 5, datë 20.12.2018 “Mbi caktimin me short të mandatit 3-vjeçar të anëtarëve gjyqtarë dhe anëtarëve jogjyqtarë”, të ndryshuar, si dhe në vendimin nr. 68, datë 25.07.2024 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, me vendimin nr. 361 datë 29.07.2024, ka vendosur :

1. *Deklarimin e mbarimit të mandatit të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor z. Alban Toro.*
2. *Përfundimi i qëndrimit në detyrë të z. Alban Toro më datë 26.07.2024.*

10.1 Për shkak të mbarimit të mandatit të relatorit të çështjes z. Alban Toro, në Mbledhjen Plenare të datës 29.07.2024, relacioni “Për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për emërim si magjistrat, profili gjyqtar, të kandidatës znj. {...}” u relatua nga anëtari zëvendësues i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, z. Ilir Rusi.

II. REZULTATET E VERIFIKIMIT PËR KUSHTET DHE KRITERET LIGJORE TË EMËRIMIT SI MAGJISTRAT, PROFILI GJYQTAR

A. Për kushtet e emërimit

11. Neni 136/a i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë përcakton se: “1. *Gjyqtarë mund të jenë shtetasit shqiptarë që emërohen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, pas përfundimit të Shkollës së Magjistraturës dhe pas kryerjes së procesit të verifikimit paraprak të pasurisë dhe të figurës së tyre, sipas ligjit.* 2. *Kritere të tjera për përzgjedhjen dhe emërimin e gjyqtarëve parashikohen me ligj*”.

12. Nga kjo dispozitë kushtetuese identifikohen dy kushte emërimi si magjistrat: “*shtetësia shqiptare*” dhe “*përfundimi i formimit fillestar për magjistrat në Shkollën e Magjistraturës*”.

A.1 Për kushtin e shtetësisë shqiptare

13. “Shtetësia shqiptare” është përcaktuar si kriter kandidimi për pranimin në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, referuar nenit 28, shkronja “b”, të Ligjit për Statusin. Për këtë shkak, ajo është verifikuar në rastin e kualifikimit të znj. {...} për në formimin fillestar në Shkollën e

Magjistraturës, për magjistrat, profili gjyqtar, në vitin akademik 2021 - 2022, sipas Vendimit nr.475, datë 19.10.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

14. Pavarësisht kësaj, sa kohë kjo rrethanë është e ndryshueshme, në funksion të verifikimit të kushtit të emërimit si magjistrat, profili gjyqtar, të znj. {...}, kjo rrethanë verifikua sërish. Gjatë verifikimit nuk u gjet ndonjë e dhënë për heqjen e shtetësisë shqiptare për këtë kandidatë. Përkundrazi, nga verifikimi i bërë, më datë 26.04.2024, në regjistrin kombëtar elektronik të gjendjes civile të administruar nga Ministria e Brendshme (Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile), sipas të dhënave elektronike vënë në dispozicion nga nëpunësi i ngarkuar i Këshillit, konstatohet se kandidatja vijon të ketë shtetësinë shqiptare, duke përmbushur kështu këtë kusht emërimi si magjistrat, profili gjyqtar.

A.1 Për kushtin e përfundimit të formimit fillestar për magjistrat në Shkollën e Magjistraturës

15. Siç u parashtua, neni 136/a i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, por edhe neni 35, pika 1, shkronja “a”, i Ligjit të Statusit¹, për t’u emëruar magjistrat, profili gjyqtar, kërkojnë përfundimin e formimit fillestar/diplomimin në Shkollën e Magjistraturës.

16. Bazuar në Vendimin nr. 23, datë 28.06.2024 të Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës, përcjellë me anë të postës elektronike dhe regjistruar në Këshill me aktin nr. 3499 prot., datë 03.07.2024, konstatohet se znj. {...} ka përfunduar programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës gjatë periudhës Tetor 2021- Qershor 2024 dhe në përfundim të vitit akademik 2023-2024 është diplomuar magjistrat, profili gjyqtar, duke përmbushur kështu këtë kusht emërimi si magjistrat, profili gjyqtar.

B. Për kriteret e emërimit

17. Neni 136/a i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ka përcaktuar se gjyqtarët emërohen pas kryerjes së procesit të verifikimit paraprak të pasurisë dhe të figurës së tyre, sipas ligjit, ndërkohë që kriteret e tjera për përzgjedhjen dhe emërimin e gjyqtarëve parashikohen me ligj. Në bazë të këtij autorizimi kushtetues, Ligji për Statusin, në nenin 35, ka përcaktuar kriteret e emërimit të kandidatit magjistrat të diplomuar.

B.1 Për kriterin e vlerësimit nga Shkolla e Magjistraturës

18. Neni 35, pika 1, shkronjat “a” dhe “b”, të Ligjit për Statusin, për emërimin magjistrat, kërkojnë që kandidati të jetë diplomuar në Shkollën e Magjistraturës, në formimin fillestar, me të paktën 70

¹ “1. I diplomuari emërohet magjistrat ...”.

për qind të pikëve maksimale të mundshme, si dhe të jetë vlerësuar minimalisht “mirë” për të gjitha detyrat e dhëna gjatë stazhit profesional në vitin e tretë të formimit fillestar.

19. Bazuar në dokumentacionin e kandidatës {...}, përcjellë me Shkresën nr.3499 prot., datë 03.07.2024, të Shkollës së Magjistraturës, konstatohet se kandidatja znj. {...} është diplomuar magjistrat, profili gjyqtar, në përfundim të vitit akademik 2023-2024:

- a) me 92.55% të pikëve, pra *“është diplomuar me të paktën 70 për qind të pikëve maksimale të mundshme”*;
- b) është vlerësuar me 600 pikë, domethënë “Shumë mirë”, për të gjitha detyrat e dhëna gjatë stazhit profesional në vitin e tretë të formimit fillestar, pra *“është vlerësuar minimalisht “mirë” për të gjitha detyrat e dhëna gjatë stazhit profesional në vitin e tretë të formimit fillestar”*.

20. Nga sa rezulton nga verifikimi, kandidatja znj. {...} plotëson këto kritere të emërimit si magjistrat, profili gjyqtar.

B.2 Për kriterin e pasurisë

21. Neni 35, pika 1, shkronja “c”, e Ligjit për Statusin, për emërimin magjistrat, kërkon që kandidati të këtë kaluar sërish verifikimin e pasurisë, në përputhje me parashikimet në pikat 2 deri në 6, të nenit 32, të këtij ligji.

22. Ndërkohë, neni 32 i Ligjit për Statusin përcakton se: *“... 2. ... Këshillat kërkojnë raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë ..., nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, ..., organet e administratës tatimore dhe doganore, ..., si dhe çdo organ publik, person fizik ose juridik që disponon të dhëna të vlefshme për qëllimet e verifikimit. Nëse është e nevojshme, Këshillat kërkojnë informacion shtesë nga institucionet e përmendura në këtë pikë. ... 4/1. Këshillat vendosin që kandidati nuk kalon procesin e verifikimit të pasurisë ... kur: a) burimet financiare të kandidatit nuk justifikojnë pasuritë e tij dhe nuk ka deklaruar pasuri ose asete duke i fshehur ato, ose në mënyrë të qëllimshme ka dhënë një deklaratë të rreme ose jo të saktë të aseteve, ose kandidati gjendet në situatën e konfliktit të interesit; ...”*.

23. Në rastin e kandidimit për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, znj. {...} i është nënshtruar verifikimit të pasurisë, në përfundim të cilit është konkluduar se ajo plotësonte këtë kriter, referuar Vendimit nr.475, datë 19.10.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

24. Për verifikimin sërish të kriterit të pasurisë për kandidaten znj. {...} u kërkua raportim nga organet e përcaktuara në pikën 2, të nenit 32, të Ligjit të Statusit, i ndryshuar.

25. Konkretisht, u kërkua raportim nga ILDKPKI-ja, e cila ka dërguar, në Këshillin e Lartë Gjyqësor, Raportin nr.47/23 prot., datë 30.04.2024.

26. Sipas Raportit të ILDKPKI-së, kandidatja znj. {...} ka plotësuar dhe depozituar në afatin e caktuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor formularin e deklaratës së pasurisë, si dhe autorizimet e kërkuara për verifikimin e pasurisë.

27. Po ashtu, sipas Raportit të ILDKPKI-së, nga kjo e fundit janë kryer kontrollet e plota për pasuritë, asetet dhe interesat e deklaruara nga kandidatja, për periudhën mbas kontrollit të plotë pasuror të kryer për të si kandidate për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës dhe deri në datën e dorëzimit të deklaratës së pasurisë, duke konkluduar se për kandidaten:

- a) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
- b) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë;
- c) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- d) nuk ka kryer deklaram të rremë;
- e) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

28. Për verifikimin sërish të kriterit të pasurisë për kandidaten znj. {...} iu kërkua informacion Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

28.1 Nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve informacioni u dërgua me shkresën nr. 2016/1 prot., datë 12.02.2024, protokolluar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor me nr. 611/18 prot., datë 23.02.2024, ku për kandidaten {...}, nuk jepen të dhëna për aktivitete tregtare.

28.2 Nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave informacioni u dërgua me shkresën nr. 2248/2 prot., datë 06.03.2024, protokolluar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor me nr. 611/21 prot., datë 07.03.2024, ku për kandidaten {...} nuk jepet ndonjë e dhënë me karakter pasuror.

29. Të dhënat e dërguara përmes informacioneve respektive nga organet si më lart u ballafaquan me të dhënat sipas Raportit të ILDKPKI-së, duke u vlerësuar se nuk kishte vend për t'i kërkuar ILDKPKI-së bërja e një kontrolli shtesë.

30. Gjatë verifikimit nuk rezultoi nevoja për kërkimin e ndonjë të dhëne tjetër të vlefshme për qëllimet e verifikimit, pranë ndonjë organi publik, personi fizik ose juridik tjetër.

31. Nga verifikimi sërish i kriterit të pasurisë për kandidaten znj. {...} janë grumbulluar të dhëna të mjaftueshme mbi të cilat mund të konkludohet për ekzistencën e shkaqeve të kualifikimit ose skualifikimit të saj. Konkretisht, të dhëna në lidhje me:

- a) plotësimin, depozitimin ose jo nga kandidatja, të formularit të deklaratës së pasurisë;
- b) plotësimin, depozitimin ose jo nga kandidatja, të nënshkruara, të autorizimeve të kërkuara për verifikimin e pasurisë;
- c) burimet financiare të kandidates dhe justifikimin ose jo të pasurisë së saj;
- ç) plotësinë, vërtetësinë dhe saktësinë ose jo, të deklaramit të pasurisë, aseteve ose të interesave private, të detyrueshme për t'u deklaruar.

B.3 Për kriterin e figurës

32. Neni 35, pika 1, shkronja “c”, e Ligjit për Statusin, për emërimin magistrat, kërkon që kandidati të këtë kaluar sërish verifikimin e figurës, në përputhje me parashikimet në pikat 2 deri në 6, të nenit 32, të këtij ligji.

33. Ndërkohë, neni 32 i Ligjit për Statusin përcakton se: “... 2. ... *Këshillat kërkojnë raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e ... figurës ..., prokuroria, gjykata, ..., Byroja Kombëtare e Hetimit, shërbimet shtetërore informative, ..., si dhe çdo organ publik, person fizik ose juridik që disponon të dhëna të vlefshme për qëllimet e verifikimit. Nëse është e nevojshme, Këshillat kërkojnë informacion shtesë nga institucionet e përmendura në këtë pikë. ... 4/1. Këshillat vendosin që kandidati nuk kalon procesin e verifikimit të ... figurës kur: ...; b) kandidati ka lidhje ose kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar; c) ka shfaqur sjellje të rënda të papërshtatshme etike dhe morale që cenojnë besimin e publikut në sistemin gjyqësor ...”.*

34. Në rastin e kandidimit për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, znj. {...} i është nënshtruar verifikimit të figurës, në përfundim të cilit është konkluduar se ajo plotësonte këtë kriter, referuar Vendimit nr.475, datë 19.10.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

35. Për verifikimin sërish të kriterit të figurës për kandidaten znj. {...} u kërkuar raportim nga institucionet ligjzbatuese të përcaktuara në pikën 2, të nenit 32, të Ligjit të Statusit, i ndryshuar.

36. Nga raportimet e shërbimeve shtetërore informative nuk u identifikua dhe verifikua ndonjë e dhënë për lidhje ose kontakte të papërshtatshme të kandidates znj. {...} me persona të përfshirë në

krimin e organizuar apo për përfshirjen e saj në veprimtari që cenojnë sigurinë kombëtare apo aktivitete të kundërligjshme.

37. Nga raportimi i Byrosë Kombëtare të Hetimit, sipas shkresës nr. 127/1 prot., datë 16.02.2024, protokolluar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor me nr. 611/17 prot., datë 19.02.2024, nuk rezultoi ndonjë informacion i vlefshëm për qëllimet e verifikimit për kandidaten znj. {...}.

38. Për kandidaten znj. {...}, në kushtet kur ajo, në momentin e kandidimit për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, ka përmbushur detyrimet sipas Ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, i ndryshuar dhe i është nënshtruar kontrollit sipas këtij ligji, referuar për këtë Vendimit nr.475, datë 19.10.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në funksion të verifikimit sërish të figurës për të, u kërkua informacion i përditësuar nga Struktura e Posaçme pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor. Kjo e fundit, me shkresën nr. 610/5 prot., datë 29.02.2024, për kandidaten znj. {...} informoi se: *-ka dorëzuar Formularin e Vetëdeklarimit me datë 04.06.2021;-formulari është regjistruar me numrin unik 000569;-vetëdeklarimi është publikuar në faqen zyrtare web të KLGJ-së;- në formular nuk ka deklaruar ndryshime;-Sektori i Gjendjes Civile, personi rezulton se me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 56, dt. 19.12.2001 kanë bërë ndryshim mbiemri familjarisht nga “Maqellari” në “Naqellari”. (Nuk ka ndryshime të tjera); -Sektori i Gjendjes Gjyqësore, personi rezulton (e padënuar) nga gjykatat penale shqiptare; - deri më sot nuk kemi pasur indicie apo të dhëna kryesisht, për të kërkuar verifikim të thelluar nga Prokuroria e Përgjithshme.*

39. Për verifikimin sërish të figurës së kandidates znj. {...} u kërkua informacion nga Prokuroria e Përgjithshme, e cila, me shkresën nr. 166/15 prot., datë 25.03.2024, protokolluar në Këshill me nr. 611/26 prot., datë 27.03.2024, ka dërguar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor informacionin e përcjellë nga prokuroritë pranë gjykatave të rretheve gjyqësore me juridiksion të përgjithshëm. Sipas informacioneve të administruara, rezulton se “... znj.{...} nuk është marrë në cilësinë e personit në hetim në një ndonjë procedim penal, ndaj saj nuk janë zbatuar masa sigurimi me karakter personal ose pasuror, nuk ka të dhëna për procedime penale të mos filluara, pushuara apo pezulluara, për periudhën Tetor 2021 e në vijim...”

40. Për verifikimin sërish të kriterit të figurës për kandidaten znj. {...} u kërkua informacion nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, e cila e ka dërguar atë me shkresën nr.2108/1 prot., datë 14.02.2024, protokolluar në Këshill me nr. 611/15 prot., datë 15.02.2024 nga përmbajtja e të cilës nuk rezulton që ndaj kandidates të jetë regjistruar kallëzim/referim/procedim penal.

41. Për verifikimin e figurës së kandidateve, mbi kërkesën e Këshillit të Lartë Gjyqësor, Gjykata e Lartë dhe të gjithë Gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm dhe të posaçëm kanë kryer verifikimin përkatës, të cilat në kohë të ndryshme kanë përcjellë pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor informacionin për kandidatët që priten të diplomohen në Shkollën e Magjistraturës, ndër ta edhe

për znj. {...}. Sipas informacioneve të administruara, rezulton se “... znj. {...} nuk ka asnjë çështje të regjistruar apo vendim të dhënë në ngarkim të saj ...”

42. Së fundi, për verifikimin sërish të kriterit të figurës për kandidaten znj. {...} u kërkua informacion nga Shkolla e Magjistraturës lidhur me disiplinën e kandidates gjatë ndjekjes së programit të formimit fillestar për magjistrat në kushtet kur, sipas nenit 255 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar², kandidati për magjistrat është subjekt i përgjegjësisë disiplinore, ndërsa janë organet e Shkollës së Magjistraturës sipas këtij ligji³ ato që kanë përgjegjësinë e verifikimit të ankesave, hetimit të shkeljeve disiplinore dhe procedimit disiplinor të kandidatëve për magjistrat. Me shkresën nr.123/1 prot., datë 09.02.2024, protokolluar në Këshill me nr. 611/13 prot., datë 09.02.2024, ndër të tjera, Shkolla e Magjistraturës ka informuar se për kandidaten znj. {...}, organi disiplinor nuk ka regjistruar procedim disiplinor dhe kundrejt saj nuk është marrë masë disiplinore.

43. Nga verifikimi sërish i kriterit të figurës për kandidaten znj. {...} janë grumbulluar të dhëna të mjaftueshme mbi të cilat mund të konkludohet për ekzistencën e shkaqeve të kualifikimit ose skualifikimit të saj. Konkretisht, të dhëna në lidhje me:

- a) plotësimin, depozitimin ose jo nga kandidatja, të formularit të vetëdeklarimit sipas kërkesave të Ligjit nr. 138/2015 dhe për ekzistencën ose jo të ndalimeve sipas këtij ligji;
- b) plotësimin, depozitimin ose jo nga kandidatja, të nënshkruara, të autorizimit për Këshillin e Lartë Gjyqësor që, në zbatim të pikës 2 të nenit 32 të Ligjit për Statusin, të kryejë verifikimin në organet kompetente sipas ligjit, për të dhënat që lidhen me figurën dhe integritetin e saj;
- c) ekzistencën ose jo të lidhjeve ose kontakte të papërshtatshme të kandidates me persona të përfshirë në krimin e organizuar;

² “...kandidatët për magjistratë mbajnë përgjegjësi për shkeljet disiplinore, në përputhje me këtë ligj dhe rregulloren e brendshme të shkollës”.

³ Neni 256, sipas të cilit: “1. Prokurori për Disiplinën, i caktuar në përputhje me nenin 248, pika 1, shkronja "gj", kryen verifikimin e ankesave dhe hetimin e shkeljeve disiplinore të pretenduara të kandidatëve për magjistratë. Në rast parandalimi ose konflikti të interesave ai përfaqësohet nga Zëvendësprokurori për Disiplinën, i caktuar në përputhje me nenin 248, pika 1, shkronja "gj", të këtij ligji. ...”, si dhe neni 257, sipas të cilit: “1. Komisioni Disiplinor që kryen procedimin disiplinor dhe cakton masën disiplinore është i pavarur dhe i nënshtrohet vetëm ligjit. 2. Në rastin e procedimit disiplinor ndaj kandidatit për magjistrat, Komisioni Disiplinor përbëhet nga Drejtori i Shkollës së Magjistraturës si kryetar, një gjyqtar dhe një prokuror të zgjedhur në përputhje me nenin 247, pika 1, shkronja "d", të këtij ligji, si anëtarë të Këshillit Drejtues, dhe dy kandidatë për magjistratë të zgjedhur me votë të fshehtë nga asambleja e kandidatëve për magjistratë. ...”.

- ç) ekzistencën ose jo të ndonjë të dhëne tjetër në lidhje me sjelljen etike dhe morale të saj, mbi të cilën të ngrihen dyshime për cenim të besimit të publikut në sistemin gjyqësor.

B.3 Për kriteret e zgjedhshmërisë

44. Neni 35, pika 1, shkronja “c”, e Ligjit për Statusin, për emërimin magistrat, kërkon që kandidati të këtë kaluar sërish verifikimin e figurës, në përputhje me parashikimet në pikat 2 deri në 6, të nenit 32, të këtij ligji.

45. Ndërkohë, neni 32 i Ligjit për Statusin përcakton se: “... 4/1. *Këshillat vendosin që kandidati nuk kalon procesin e verifikimit të pasurisë dhe figurës kur: ...; ç) ka ndonjë shkak tjetër përjashtues të njohur, të parashikuar sipas ligjit*”.

46. Në kuptim të shkaqeve të tjera përjashtuese në lidhje me pasurinë dhe figurën sipas shkronjës “ç”, pika 4/1, të nenit 32, të Ligjit për Statusin, sa i përket emërimit si magistrat, vlen të konsiderohen shkaqet e pazgjedhshmërisë si magistrat.

47. Shkaqet e pazgjedhshmërisë si magistrat përcaktohen në nenin 66, pika 1, të Ligjit për Statusin, sipas të cilit: “1. *Statusi i magistratit mbaron në ditën kur autoriteti kompetent përcakton me vendim shkaqet e pazgjedhshmërisë si vijon: a) kur magistrati nuk plotëson kriteret e përcaktuara, sipas nenit 28 të këtij ligji; ...*”. Pra, në kuptim të kësaj dispozite, kriteret sipas nenit 28 të ligjit janë në fakt dhe kritere zgjedhshmërie si magistrat. Po ashtu, kjo dispozitë imponon për Këshillin e Lartë Gjyqësor verifikimin pa u kufizuar në kohë të shkaqeve të pazgjedhshmërisë si magistrat, madje edhe atëherë kur statusi i magistratit është fituar. Ndaj, në kuptim të kësaj dispozite, ndërsa statusi i magistratit mund të mbarojë kur nuk plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 28 të Ligjit për Statusin, atëherë për të njëjtën arsye ai nuk mund ta fitojë këtë status, duke shërbyer në këtë mënyrë kriteret e përcaktuara nga kjo dispozitë edhe kritere zgjedhshmërie si magistrat.

48. Neni 28 i Ligjit për Statusin përcakton “*Kriteret e pranimit në formimin fillestar*”. Verifikimi i këtyre kriterëve për kandidaten znj. {...}, në përputhje me nenin 30 të Ligjit të Statusit, është bërë në momentin e kandidimit të saj për në provimin e pranimit në Shkollën e Magistraturës, ndërsa ajo është lejuar të marrë pjesë në provim, ndërkohë që, në përfundim të provimit të pranimit, Këshilli Drejtues i Shkollës së Magistraturës, më datë 14.05.2021, ka miratuar listën e renditjes me rezultatet përfundimtare të shpallura nga Komisioni i Provimit me shkrim dhe nga Komisioni i Vlerësimit të Shëndetit Mendor dhe Psikologjik, të provimit të pranimit për vitin akademik 2021-2022. Në këtë listë është përfshirë dhe kandidatja {...}.

49. Gjithsesi, për kandidaten znj. {...} është bërë verifikimi sërish i disa prej kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta për pranimin në formimin fillestar për magistrat në Shkollën e

Magjistraturës, në rastin e verifikimit të saj nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, si kandidate për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, referuar Vendimit të tij nr.475, datë 19.10.2021.

50. Në rastin e verifikimit sërish të disa prej kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta për pranimin në formimin fillestar për magistrat në Shkollën e Magjistraturës, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka mbajtur në konsideratë diferencën kohore mes momentit të aplikimit për në provimin e pranimit në Shkollën e Magjistraturës (shkurt 2021), momentit të vlerësimit përfundimtar nga Shkolla e Magjistraturës për plotësimin e kriterëve (prill 2021), si dhe momentit kur Këshilli është shprehur për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit të tij për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës (tetor 2021). Dhe po ashtu, Këshilli ka mbajtur në konsideratë dhe faktin se shumica e kriterëve të pranimit në formimin fillestar janë potencialisht të ndryshueshëm në kohë (me përjashtim të kriterit arsimor, kriterit të përvojës profesionale, kriterit të anëtarësisë në parti politike, në kohën e kandidimit dhe kriterit të anëtarësisë, bashkëpunëtorit ose të favorizuarit nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990). Gjithashtu, Këshilli ka mbajtur në konsideratë detyrimin e tij konstant për verifikimin e kriterëve të zgjedhshmërisë, të cilat janë njëherazi edhe kriteret e pranimit në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës.

51. Në kuptim të nenit 28 të Ligjit për Statusin, si kriterë zgjedhshmërie si magistrat identifikohen: *a) zotësia për të vepruar; b) shtetësia shqiptare; c) arsimimi; ç) përvoja profesionale; d) gjendja gjyqësore; dh) disiplina në punë; e) anëtarësia në parti politike në kohën e kandidimit; ë) qenia anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990; f) qenia bashkëpunëtor, informator, ose agjent i shërbimeve sekrete.*

52. Gjatë verifikimit sërish të kandidates për Këshillin e Lartë Gjyqësor nuk ka mbërritur ndonjë njoftim që të jepte shkas kryerjes së një verifikimi të thelluar mbi përmbushjen nga kandidatja të kriterëve të zgjedhshmërisë sipas nenit 28 të Ligjit për Statusin, duke mos pasur kështu për kandidaten ndonjë e dhënë e ndryshme nga ato të verifikuara më parë sa i përket kriterëve sipas kësaj dispozite.

III. KONKLUZIONE

53. Referuar përcaktimeve të Vendimit 75/2019, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar gjatë procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për kandidaten znj. {...}, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se procedura e verifikimit e ndjekur në këtë rast është e plotë dhe në përputhje me ligjin.

54. Bazuar në sa më lart është parashtruar mbi rezultatet e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për kandidaten znj. {...}, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se kandidatja i përmbush ato, ndërsa nuk ekziston ndonjë shkak për skualifikimin dhe refuzimin e emërimit të saj si gjyqtare. Nisur nga kjo, Këshilli çmon se është vendi për kualifikimin e kandidates dhe vijimin e procedurës së emërimit të saj si gjyqtare.

PËR KËTO ARSYE

Mbështetur në nenin 136/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 61, pika 2, shkronja “a” dhe nenin 97, pika 1, shkronja “a”, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 35 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Kreun VI, Seksioni Ç, pika 2, shkronja “b”, të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë” të ndryshuar, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

V E N D O S I :

1. Kualifikimin për emërim të kandidates znj. {...}, e diplomuar për magjistrat në Shkollën e Magjistraturës në vitin akademik 2023 - 2024 dhe vijimin e procedurës së emërimit si gjyqtare.
2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR